



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË
KRYETARI I KËSHILLIT**

Nr 1090 Prot

Gjirokastër më 03 : 02:2023

Lënda: Procesverbal i mbledhjes 31.01. 2023.

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/ 2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak po ju vendosim në dispozicion procesverbalin e mbledhjes së datës 31.01. 2023.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot në **datë 31.01. 2023** në mbledhjen e Këshillit Bashkiak Gjirokastër. Mbledhja po zhvillohet në ambientet e hotel “Çajupit”. Mbledhja fillon në orën 12;10

Marrin pjesë në mbledhje 17 anëtarë. Mungojnë në mbledhje; Feruni, Xheko, Hilaj, Karagjozi, Rova, Hasko, Guga, Isaraj, Kallajnxhi, Arapaj, Çamani, Qeli, Muho.

Hapet mbledhja nga Z. Hasani. Është kuorumi për fillimin e mbledhjes.

Z.Hasani lexon rendin e ditës dhe sqaron materialet shtesë të ardhura nga ekzekutivi.

Lexohet rendi i ditës me materialet shtesë dhe hidhet për miratim. Miratim i procesverbalit të mbledhjeve të datës 29.12.2022 dhe 10.01.2023.

1. Miratim i procesverbalit të mbledhjeve të datës 29.12.2022 dhe 10.01.2023.
2. P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin **01-31.01. 2023**”.
3. P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin **01-31.01. 2023**”.
4. P/Vendim “Për miratimin e përfundimit të procedurave të privatizimit të banesave , të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (sot ASHK) për lidhjen e kontratave para noterit për 7 familje”.
5. P/Vendim “Për miratimin e shtyrjes së afatit për “Subvencionin e interesit të kredisë” financuar nga buxheti i bashkisë Gjirokastër për z. Piran Mullaj”.
6. P/Vendim “ Për miratimin e vlerës së grantit të menjëhershëm” , për banesat me kosto të ulët nga buxheti i shtetit për 8 familje në vlerën 903.413 lekë”
7. P/Vendim “Për miratimin e listës së përfituesve dhe vlerës së subvencionit të qirasë për individë/familje që do të trajtohen me fonde nga buxheti I shtetit dhe Bashkia Gjirokastër, pasi e kanë të vështirë të përballojnë qiranë në tregun e lirë”.
8. P/Vendim “Për miratimin e listës emërore të familjeve përfituese si dhe vlerës së bashkëfinancimit me qëllim përfitimin e fondeve nga programi i strehimit “ përmirësimi i banesave egzistuese “ për vitin 2023”



9. P/Vendim “Për miratimin në parim të bashkëfinacimit në kuotën 20% të vlerës preventivit në zbatim të projektit “Banesa sociale me qira të cilat mund të sigurohen nëpërmjet adaptimit të objekteve egzistuese që janë në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore”.
10. P/Vendim “Për miratimin e listës së parcelave kullosore verore /dimërore që do të kontraktohen për përdorim me qira për kullotje për sezonin veror 2023 dhe sezonin dimëror 2023-2024”.
Të tjera:
11. P/Vendim “ Për një ndryshim në VKB Nr. 58, datë 30.06.2021 “ Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Gjirokastrë për fillimin e procedurave të shpronësimit për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private që do të preken pjesërisht nga zgjerimi i Varrezave Publike të qytetit”
12. P/Vendim “ Për vendosjen në shtëpinë e të moshuarve”
13. P/Vendim “Për miratimin e zgjatjes edhe me 1 vit të projektit për ofrimin e shërbimeve në qendrën e emergjencës ku trajtohen viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, ku 30 % financohet nga ministria e shëndetësisë dhe 70 % nga bashkia gjirokastrë, në vitin e 4-të të zbatimit”.
14. Të ndryshme.

Hidhet në votë dhe miratohet rendi i ditës me 17 vota pro.

Miratoohen me 17 vota pro procesverbalet e datës 29.12.2022 dhe 10.01.2023.

Hidhen në votë dhe miratohen me 17 vota pro pikat 2, 3 dhe 12 të rendit të ditës që kanë të bëjnë me:

P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin **01-31.01. 2023**”.

P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin **01-31.01. 2023**”.

P/Vendim “ Për vendosjen në shtëpinë e të moshuarve”

Për pikat 4, 5 dhe 7 të rendit të ditës shprehet në emër të Komisionit të Shëndetësisë, Çeshtjeve Sociale dhe Barazisë Gjinore Znj. Qafzezi:

Është mbledhur komisioni dhe kemi marrë sqarimet e duhura nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale.

Pyetje për procedurë : A janë përfshirë familjet të tjera në nevojë, gra të dhunuara, familjarë të vetëm etj?

Komisioni shpreh dakortësinë për t'u kaluar në mbledhjen e sotme.

Hidhet në votë dhe miratohet me 17 vota pro P/Vendim “Për miratimin e përfundimit të procedurave të privatizimit të banesave, të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (sot ASHK) për lidhjen e kontratave para noterit për 7 familje”.

Sqaron për pikën 5 të rendit të ditës, Znj Allushi , ku personit i është miratuar nga Këshilli , por banesës i doli pronari dhe është në kërkim të një banese tjetër.

Miratohet me 17 vota pro pika 5 P/Vendim “Për miratimin e shtyrjes së afatit për “Subvencionin e interesit të kredisë” financiar nga buxheti i bashkisë Gjirokastrë për z. Piran Mullaj”.

Z. Golemi: Ju uroj mbarësi meqë është takimi i parë live për këtë vit në mbledhjet e Këshillit .

Besoj e keni vënë re se të gjitha pikat kanë të bëjnë me mbështetjen e shtresave në nevojë dhe lehtësimin e problemeve me banesat e tyre. Edhe me Paketën Fiskale ne i kemi zeruar tarifat për këto shtresa në një vlerë prej 50 milion më pak në mbledhjen e të ardhurave. Vija me propozimin që në listën me 8 familje një emër të hiqet, sepse le t'i përdorim fondet për shtresat në nevojë, sepse nuk dua të kemi keqkuptime në këtë pikë. Unë propozoj ndryshimin, kurse ju miratojeni si të doni.

Z. Rexhaj: Më vjen mirë që e tërhiqni nga ana morale, edhe pse nga ana ligjore i takon kjo.

Z. Brahim: Nëse i takon ligjërisht, pse të mos e marrë, nuk kemi pse e pengojmë këtë gjë.

Z. Hasani: Unë mendoj se moralisht duhet ta kishit hequr pa ardhur këtu. Mund të kemi edhe raste të tjera në vazhdim dhe nuk mund të bëhemi pengesë. Nëse i plotëson kushtet pse të mos e marrë?

Hidhet në votë dhe miratohet me 17 vota pro P/Vendim "Për miratimin e vlerës së grantit të menjëhershëm", për banesat me kosto të ulët nga buxheti i shtetit për 8 familje në vlerën 903.413 lekë" me ndryshimin e propozuar për 7 dhe jo 8 familje. Miratohet me ndryshimin për heqjen e emrit nr 5. në listë

Hidhen për diskutim pikat 7, 8 dhe 9 të rendit të ditës, të cilat janë ndarë në dy projekte nga ekzekutivi.

Z. Rexhaj: Më vjen mirë dhe e vlerësoj bashkinë për këto dy projekte të rëndësishme që kanë të bëjnë me anën sociale të njerëzve dhe mbështesin shtresat në nevojë.

Z. Golemi: Në projektin e parë u shpallëm fitues për 15 banesa, ku 14 janë të komunitetit rom dhe një familje në Njësinë Administrative Lunxhëri. E sollëm me nxitim për të kapur afatin e aplikimit. Afati i fundit është data 31 janar, ku kemi 18 familje si fillim dhe nuk janë vetëm të komunitetit rom. Po lexoj emrat e familjeve për të qenë transparent me qytetarët.

Projekti i dytë ka të bëjë me ish konviktin e shkollës pedagogjike, duke patur objektet tona i krijojmë kushtet dhe lehtësojmë më vonë buxhetin e bashkisë. Ju falënderoj për mbështetjen për këto dy projekte të rëndësishme.

Z. Brahim: Po familja nga Kolonja, pse nuk është në këtë listë?

Z. Golemi: Familja nga Kolonja u mbështet dhe trajtohet edhe me bonusin e qirasë, por nuk ka plotësuar dokumentacionin, kanë aplikuar 50 familje, por vetëm 18 kanë plotësuar të saktë dosjet, dhe kjo gjë do të vazhdojë.

Z. Brahim: Pse nuk e keni menduar për Shtëpinë e të Moshuarve, konviktin e pedagogjikes?

Z. Golemi: Jemi në diskutime me Ministrinë e Shëndetësisë dhe është në diskutime për objektin në Libohovë, i cili është gati dhe do të jetë si degë e Shtëpisë së të Moshuarve Gjyrokastër.

Hidhen në bllok pikat 7, 8, 9 dhe miratohen me 17 vota pro. P/Vendim "Për miratimin e listës së përfituesve dhe vlerës së subvencionit të qirasë për individë/familje që do të trajtohen me fonde nga buxheti i shtetit dhe Bashkia Gjyrokastër, pasi e kanë të vështirë të përballojnë qiranë në tregun e lirë".

P/Vendim "Për miratimin e listës emërore të familjeve përfituese si dhe vlerës së bashkëfinancimit me qëllim përfitimin e fondeve nga programi i strehimit "përmirësimi i banesave egzistuese " për vitin 2023"

P/Vendim "Për miratimin në parim të bashkëfinancimit në kuotën 20% të vlerës së preventivit në zbatim të projektit "Banesa sociale me qira të cilat mund të sigurohen nëpërmjet adaptimit të objekteve egzistuese që janë në pronësi të njësisive të vetëqeverisjes vendore".

Hidhen në votë pikat 10, 11 dhe 13 dhe miratohen me 17 vota pro. P/Vendim “Për miratimin e listës së parcelave kullosore verore /dimërore që do të kontrahohen për përdorim me qira për kullotje për sezonin veror 2023 dhe sezonin dimëror 2023-2024”.

P/Vendim “Për një ndryshim në VKB Nr. 58, datë 30.06.2021 “ Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Gjirokastrë për fillimin e procedurave të shpronësimit për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private që do të preken pjesërisht nga zgjerimi i Varrezave Publike të qytetit”

P/Vendim “Për miratimin e zgjatjes edhe me 1 vit të projektit për ofrimin e shërbimeve në qendrën e emergjencës ku trajtohen viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, ku 30 % financohet nga ministria e shëndetësisë dhe 70 % nga bashkia gjirokastrë, në vitin e 4-të të zbatimit”.

Mbyllet mbledhja nga Z. Hasani në orën 12.54 minuta.

Sekretar

Etleva Yzo



Kryetar i Këshillit

Lavdi Hasani

